

VENDIM
Nr.88, datë 16.11.2005

**“PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN E SUBJEKTEVE
JOBANKA””**

Në mbështetje të nenit 1 pika 3 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

V E N D O S I :

1. Të miratojë ndryshimet në rregulloren “Për licencimin e subjekteve jobanka”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 26.11.03 të Këshillit Mbikëqyrës si më poshtë vijon :

Pika 1. 4 bëhet pika 1.4.1 dhe shtohet një pikë tjetër, me këtë përmbajtje:

“1.4.2 Përgjashtimisht nga pika 1.4.1. subjektet që kryejnë vetëm veprimtarinë e qirasë financiare nuk konsiderohen si subjekte jobanka, sipas përcaktimit të dhënë në këtë rregullore. Veprimtaria e këtyre subjekteve rregullohet në bazë të ligjit nr.9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.”

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani